

DYQANI.IM – TERMAT DHE KUSHTET

Këto Terme dhe Kushte për përdorimin e Platformës Dyqani.im, paraqesin një pasqyrë të përgjithshme të të drejtave, detyrimeve si dhe kushteve për përdorimin e Platformës Dyqani.im. Të njëjtat përbëjnë marrëveshjen në mes të Shfrytëzuesit dhe Platformës Dyqani.im. Shfrytëzuesi duhet të lexojë dhe konfirmojë pranimin e këtyre Termeve dhe Kushteve para regjistrimit për përdorimin e Platformës Dyqani.im.

Me krijimin e llogarisë në Platformën Dyqani.im, Ju konfirmoni se i keni lexuar, kuptuar dhe i pranoni Termet dhe Kushtet e kësaj marrëveshje elektronike.

1. Rreth Platformës Dyqani.im

- a. Dyqani im Sh.P.K. është subjekt juridik që operon në Kosovë dhe është themelues i Platformës Dyqani.im. Dyqani.im është një treg që lejon Pjesëmarrësit të ofrojnë, shesin dhe blejnë pothuajse çdo gjë, në një larmi formatesh, çmimesh dhe vendndodhjesh brenda Republikës së Kosovës. Kjo Platformë krijon një treg i cili bën të mundur për të lidhur Shitësit me Blerësit (“Pjesëmarrësit”), në mënyrë që më pas të njëjtët të kryejnë transaksionet e dëshiruara.
- b. Për këtë arsye, Kompania Dyqani im Sh.P.K. ka hartuar këtë dokument i cili përmban Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të përdorimit që janë të detyrueshme për të vazhduar më tutje shfrytëzimin e shërbimeve dhe produkteve të Dyqani.im, dhe në momentin e pranimin të tyre, trajtohen si kontratë e lidhur në mes të: “Dyqani im” Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me Numër Unik Identifikues 811357955 dhe me adresë në Rruga Bekim Fehmiu, p.n., 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës; dhe Juve si përdorues, në bazë të të dhënave të ofruara në momentin e regjistrimit tuaj në platformë, tash e tutje referuar si “Pjesëmarrësi”; ashtu që të njoftoheni me dispozitat të cilat definojnë marrëdhënien tonë me ju, nga aspekti juridik.
- c. Platforma Dyqani.im do të ofrojë një platformë të avancuar online për të gjithë Pjesëmarrësit e interesuar, e cila përmban një gamë të gjerë të produkteve të cilat ofrohen nga persona dhe kompani të ndryshme me të dhëna të plota për produktet e ofruara, vlerësime të produkteve, fotografi dhe detaje tjera të rëndësishme që kanë për qëllim t’i ofrojnë konsumatorëve të platformës Dyqani.im një pasqyrë të plotë të produkteve për të cilat kanë interes të bëjnë blerjen, tash e tutje të referuara si **“Produktet”**.

2. Qasja dhe përdorimi i Platformës Dyqani.im

- a. Platforma Dyqani.im mund të përdoret falas nga secili Pjesëmarrës i cili ka qasje në internet. Pjesëmarrësit janë përgjegjës për funksionimin e duhur të pajisjeve të tyre nëpërmjet të cilave kanë qasje në Platformën Dyqani.im si dhe për funksionimin e rregullt të linjës së tyre të internetit.
- b. Platforma Dyqani.im rezervon të drejtën për të ndërprerë, pezulluar përkohësisht apo për të modifikuar, pa njoftim paraprak, qasjen në një pjesë apo në të gjitha pjesët e Platformës, për

qëllime të mirëmbajtjes apo arsye tjera. Këto veprime nga ana e Platformës Dyqani.im nuk krijojnë asnjë lloj të drejte për Pjesëmarrësit, përfshirë të drejtën për të kërkuar kompensim.

- c. Qasja në shërbimet e ofruara nga Platforma Dyqani.im do të kërkojë hapjen e një Llogarie Personale brenda Platformës. Duke u regjistruar në Platformën Dyqani.im, Pjesëmarrësve do t'u vihen në dispozicion kredencialet private të identifikimit, të cilat përfshijnë emrin, adresën, numrin e telefonit dhe email adresën si dhe një fjalëkalim, të cilat duhet të ruhen në mënyrë tërësisht konfidenciale.
- d. Me qëllim të shmangies së ç'orientimeve, Pjesëmarrësit me pranimin e këtyre Termeve dhe Kushteve obligohet të ofrojnë informacion të saktë dhe të përditësuar lidhur me identitetin e tyre, adresën si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për t'u qasur në Platformën Dyqani.im. Këta Pjesëmarrës, janë po ashtu përgjegjës për ndërmarrjen e të gjithë hapave të nevojshëm për të mbrojtur të dhënat dhe/apo kredencialet e tyre nga qasjet potenciale të paautorizuara.
- e. Për të përfituar nga qasja në Platformën Dyqani.im, pjesëmarrësit duhet që:
 - të jenë persona fizikë mbi moshën 18 vjeçare, me kapacitet ligjor për të hyrë në kontrata dhe me një adresë valide të dërgesës; apo
 - të jenë persona juridikë, përfaqësuesi i autorizuar i të cilëve duhet të ofrojë informacion të vlefshëm lidhur me identitetin e tij (emrin dhe mbiemrin), emërtimin e kompanisë, numrin unik të identifikimit, adresën në të cilën është e regjistruar selia e kompanisë, numrin e telefonit dhe email adresën.
- f. Pjesëmarrësit njëkohësisht pajtohen që të mos hapin apo përdorin llogari të tjera, të ndryshme nga ato që i kanë hapur fillimisht, qoftë nën identitetin e tyre apo të palëve të treta, pa autorizimin e shkruar dhe specifik të Platformës Dyqani.im.

3. Kohëzgjatja e llogarisë dhe Përfundimi i Marrëveshjes

- a. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së llogarisë së Pjesëmarrësit do të jetë për një kohë të pacaktuar. Megjithatë, Pjesëmarrësit shprehimisht pranojnë që Platforma Dyqani.Im mundet që ta ndërprejë marrëveshjen me një periudhë njoftimi paraprake prej tridhjetë (30) ditësh.
- b. Po ashtu, pa paragjykuar të drejtën për kompensimin e dëmit apo veprimet ligjore që mund të ndërmerren ndaj një Pjesëmarrësi, Platforma Dyqani.im mundet që në rast të shkeljeve të rënda dhe të përsëritura të dispozitave të kësaj marrëveshje si dhe legjislacionit në fuqi, posaçërisht në rast të ofrimit për shitje të produkteve të ndaluara, informacionit të pasaktë, mashtrimit me pagesa, apo çfarëdo lloj vepre penale tjetër, ta ndërprejë marrëveshjen si dhe ta pezullojë apo ç'aktivizojë, pa paralajmërim llogarinë e qasjes. Me këtë rast, Shitësi nuk mundet që të kërkojë kompensimin e çfarëdo shpenzimi për vendosjen e produktit për shitje në Platformën Dyqani.im.

4. Ofrimi i produkteve

- a. Platforma Dyqani.im, i lejon Shitësve që t'i ofrojë Blerësve produktet e tyre.

- b. Për produktet te cilat gjenden në shitje Blerësit mund të kërkojnë në kategoritë e produkteve të klasifikuara nga Platforma Dyqani.Im. Pasi të kryejnë zgjedhjen e tyre, Blerësi mund t'i vendosë produktet e zgjedhura në “shportë” dhe e finalizon shitblerjen me Shitësit të cilët kanë qenë në gjendje që të përmbushin kërkesat e tyre.
- c. Pagesat për produktin e blerë bëhen nëpërmjet llogarisë bankare të Dyqani.im apo përmes pagesës cash (para në dorë) kur dorëzohet produkti. Të gjitha pagesat përfshijnë edhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (nëse ajo aplikohet nga shitësi)

5. Detyrimet e Shitësit

Shitësi është i obliguar që:

- a. Të garantojë se produkti i vendosur për shitje në Platformën Dyqani.im është nën pronësinë e tij dhe nuk përmban asnjë të metë juridike..
- b. Të publikoj produktin/et për shitje, me specifika të sakta, me fotografi reale, me çmim të njëjtë me çmimin që e ka në shitje në ambientin e vetë dhe të ofroj garancion të produktit pa kushtëzime, njësojë sikurse blerësi të kishte produktin pa-ndërmjetësues.
- c. Të mirëmbajë sasinë e produktit të publikuar - ta njoftoj ndërmjetësuesin me shkrim, ose ta evidentoj sasinë në platformën dyqani.im.
- d. Të njoftojë ndërmjetësuesin me shkrim për zbritjet/ofertat e produktit/eve, dhe të publikojë zbritjet e produktit/eve në platformën e Dyqani.im.
- e. Të përgatis produktin/produktet për transport nga ndërmjetësuesi, jo më vonë se dy (2) orë para kohës së caktuar nga ndërmjetësuesi.
- f. Të prezantoj produktin para ndërmjetësuesit dhe të argumentoj përputhshmërinë me specifikacionin e publikuar në dyqani.im
- g. Ta pllomboj paketimin, bashkë me ndërmjetësuesin ose palën e autorizuar nga ai.
- h. Të siguroj një llogari bankare për pranimin e pagesës për mallin e shitur, ose të pranoj çek bankar si mjet për realizimin e pagesës (minus kostoja e shërbimit të ndërmjetësuesit), nëse produkti/et është në harmoni me informacionin e publikuar.

6. Detyrimet e Dyqani.im

Në të gjitha rastet, Platforma Dyqani.im vepron vetëm si ndërmjetës/agent dhe organizues i transportit. Detyrimet e Dyqani.im në këtë cilësi janë:

- a. Të krijoj, mirëmbajë dhe avancoj, sipas nevojave të veta, platformën softuerike (dyqani.im) me qëllim të realizimit të shit-blerjeve të produkteve.
- b. Të aprovoj produktet që janë në shitje, t'i korrigjoj materialet gjuhësore dhe semantike (pa ndikuar vetitë dhe elemente tjera të produktit.) T'i refuzoj produktet që mund të identifikohen që nuk janë oferta reale, apo të plota, apo cilindo veprim që dyshohet se nuk është real, etik apo ligjor.
- c. Të kryej transportin prej shitësit tek blerësi, apo anasjelltas, nëse produkti/et nuk janë komfor specifikimit të publikuar.
- d. Të bëjë reklamë, për produktet e publikuara në platformë, sipas vlerësimeve të tij.
- e. Të trajnoj, udhëzoj ose përkrahë (nga distanca) publikuesit e produkteve, nëse ka nevojë.

7. Detyrimet e blerësit

Blerësi është i obliguar që të jetë korrekt me rastin e porosisë, përkatësisht:

- a. Të bëjë VETËM porosi reale, ose ta anuloj atë jo më vonë se dy (2) orë pas dhënies së porosisë.
- b. Të jetë në lokacionin dhe kohën e caktuar nga ai për pranimin e mallit.
- c. Të sigurohet që ka mbulesë financiare (të holla të mjaftueshme) për pagesën e faturës të përmbledhur tek shporta.
- d. Të verifikoj dhe konfirmoj kodin e pllombimit të shitësit.
- e. Të nënshkruaj pranimin e mallit, atëherë kur dërgesa është në harmoni me publikimin dhe ta evidentoj kodin e faturës në platformë.
- f. Të nënshkruaj arsyetimin e refuzimit të mallit, nëse ajo ka ndodhur dhe ta evidentoj në platformë.
- g. Të kryej pagesën, sipas çmimit/shumës së publikuar në platformën dyqani.im.

8. Dërgimi dhe Konformiteti i Produkteve

- a. Pas realizimit të porosisë, produktet duhet të dërgohen nga Dyqani.im në adresën e paraqitur nga blerësi në porosinë e tij. Dërgimi duhet të bëhet në bazë të zgjedhjes së Blerësit. Kësisoj, kostoja e dërgimit mund të ndryshojë në bazë të mënyrë së zgjedhur të dërgimit apo shumës së blerjes.

- b. Nëse Blerësi përkundër kontrollimit dhe konfirmimit ashtu siç është paraparë në nenin 7 pikën f) të kësaj kontrate, vëren se produkti ka ndonjë të metë, ai duhet që brenda 1 dite, nga dita e blerjes të kontaktoj Dyqani.im. Produkti mund të kthehet vetëm në rastet kur i njëjti nuk ka pësuar dëm dhe është i vendosur në ambalazhin e tij origjinal së bashku me të gjitha pjesët përcjellëse.

8.1 Disponueshmëria e produkteve

- a. Nëse një produkt nuk është i disponueshëm, Blerësit që kanë paguar tashmë do të informohen me postë elektronike para çdo anulimi të porosisë së tyre që: atyre do t'u dorëzohet një produkt i një cilësie dhe çmimi ekuivalent me atë të porositur fillimisht, në varësi të disponueshmërisë; ose atyre do t'u kthehet shuma totale e produktit apo produkteve të padisponueshme, brenda jo më shumë se një dite, përveç rasteve të jashtëzakonshme.
- b. Fakti që një ose më shumë Produkte të porositura, nga një ose më shumë Shitës në Platformën Dyqani.im, nuk janë në dispozicion, nuk do të përbëjë bazë për anulimin e të gjitha produkteve të porositura, pasi blerësit janë të detyruar të pranojnë ofertën për secilin prej produkteve të tjera që janë në dispozicion.

8.2 Produkti i dëmtuar ose jo konform në kohën e dorëzimit

- a. Nëse është marrë një produkt i dëmtuar ose në ndonjë mënyrë tjetër që nuk është konform me prezantimin e tij, Blerësi, brenda afatit të përcaktuar në nenin 8 par. b) të kësaj kontrate, do të kontaktojë Dyqani.im, i cili e kontakton Shitësin në mënyrë që të përcaktohen masat që duhet të merren për të zgjidhur problemin.
- b. Pasi të konfirmojë mospërputhjen e Produktit në lidhje me ofertën e Shitësit, Dyqani.im do të këmbëjë Produktin me një produkt me cilësi të njëjtë ose më të mirë, në varësi të disponueshmërisë së Shitësit, ose do të kthejë blerjen. Kosto e transportit në raste të tilla mbulohen nga Shitësi.
- c. Në rast të kthimit të produktit për arsyet e parapara në paragrafin a) të këtij neni, Shitësi, para se ta marr produktin e kthyer, është i obliguar që të kompenzojë platformën Dyqani.im dëmshpërblim në vlerën prej 5% (pesë përqind) të vlerës së produktit si dhe koston e transportit. Produkti mbetet në posedim të Dyqani.im deri në momentin e kryerjes së obligimit nga ana e Shitësit ashtu siç është paraparë në këtë paragraf.

9. Pronësia Intelektuale

- a. Të gjithë elementët që përbëjnë Platformën Dyqani.im (vepra dhe krijime të ndryshme të mbrojtura, tekst, grafikë, softuer, fotografi, imazhe, video, tinguj, plane, emra, logot, emrat e tregtisë dhe bazat e të dhënave etj) dhe Uebfaqja në vetvete, janë të përfshira në legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

- b. Çfarëdo përdorimi i elementeve të platformës që nuk është aprovuar shprehimisht, nënkupton shkelje të së drejtës së autorit sipas ligjeve në fuqi.
- c. Përveç nëse është dhënë pajtimi me shkrim nga platforma dyqani.im, pjesëmarrësit tjerë nënshkrues, marrin përsipër të përmbahen nga ndryshimi, kopjimi, riprodhimi, ribotimi, shkarkimi, vendosja në internet, duke transmetuar, shitur ose shpërndarë në çfarëdo mënyre çfarëdo, në një server tjetër ose në një vend tjetër, përmbajtja e vënë në dispozicion të tij nga dyqani.im, përfshirë të dhënat lidhur me produktet apo kodet e ndryshme.
- d. Pëlqimi për t'i riprodhuar përmbajtjet e platformës dyqani.im, do të mund t'u ipet pjesëmarrësve në mënyrë elektronike apo fizike.

10. Mosdhënia e Garancionit dhe Përrjashtimi i Përgjegjësisë

- a. Shërbimet e platformës Dyqani.im, do të ofrohen mbi bazën “per se” pa ndonjë garacion. Dyqani.im shprehimisht përjashton, në masën e lejuar me ligj, të gjitha garacionet e shprehura, të nënkuptuara ose statusore, duke përfshirë pa ndonjë kufizim garancitë e tregtisë apo për mosshkelje të së drejtës së autorit.
- b. Platforma dyqani.im përjashton çfarëdo garancie lidhur me produktet e ofruara nga shitësit si dhe sigurinë, besueshmërinë dhe performancën e shërbimeve të tij.
- c. Tutje, dyqani.im nuk pranon asnjë përgjegjësi lidhur me:
 - fshirje, pamundësi e ruajtjes, transmetimit të pasaktë ose transmetimit jo të duhur të informacionit ose të dhënave të paraqitura në Uebfaqe ose që rrjedhin nga shërbimet që ofrohen nga platforma;
 - kostot nga humbja e fitimit dhe / apo humbja e të dhënave;
 - performancën ose mos-performancën e Shërbimeve të kësaj platforme, të informacioneve ose produkte që paraqiten në rezultatet e propozuara;
 - dëmtime që mund të vijnë nga shkarkimi ose përdorimi i informacionit ose të dhënave të disponueshme në internet përmes shërbimeve të kësaj platforme, siç janë dëmtimi i shkaktuar në sistemet kompjuterike dhe humbjen e të dhënave; dhe
 - formatin ose përmbajtjen e informacionit të vendosur në internet në hapësirat e tyre nga Pjesëmarrësit.
- d. Këto kufizime të përgjegjësisë do të zbatohen në mënyrë që të parandalojnë pretendimet për dëme, goftë direkte ose indirekte, ose të ardhshme, pavarësisht nga shkaqet që sjellin deri tek dëmtimet (përfshirë dëmi i pësuar nga palët e treta).

11. Mosmarrëveshjet dhe Ligji i Zbatueshëm

- a. Pjesëmarrësit pajtohen që gjitha mos-marrëveshjet eventuale që mund të lindin nga përdorimi i platformës dyqani.im, të mundohen t'i zgjidhin me anë të bisedave të ndërsjella dhe atë në një afat prej tridhjetë (30) ditësh.

- b. Në rast se palët dështojnë të zgjidhin mosmarrëveshjet brenda afatit të paraparë në paragrafin e lartcekur, palët do të mund t'i drejtohen departamentit kompetent brenda Gjykatës Themelore në Prishtinë.

12. Saktësimi dhe procesimi i të dhënave personale

- a. Ju zotoheni se të dhënat që ju i deklaroni gjatë regjistrimit në Platformën Dyqani.im janë tuajat dhe janë të vërteta dhe të përditësuara apo do t'i përditësoni kurdo që ato pësojnë ndonjë ndryshim.
- b. Platforma Dyqani.im, gjatë procesimit të të dhënave tuaja dhe/apo përfaqësuesit tuaj, do të veprojë në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe në përputhje me aktet tjera ligjore në fuqi.
- c. Të dhënat personale të cilat i keni futur gjatë hapjes së llogarisë, do të përdoren për qëllim të dërgimit të informacioneve, promovimit, menaxhimit të llogarisë tuaj, ekzekutimit të transaksioneve dhe kthimit të fondeve.
- d. Me pranimin e kësaj marrëveshje, ju po ashtu pranoni se të dhënat tuaja personale dhe ato të kontaktit, të cilat janë të lidhura me këtë marrëveshje, mund të transferohen tek:
- i. Persona të tretë me të cilët Platforma Dyqani.im mund të ketë marrëdhënie kontraktuale, me qëllim të ekzekutimit të transaksioneve apo ofrimit të shërbimeve tjera, me kusht që të njëjtit respektojnë privatësinë në nivelin që i detyron legjislacioni përkatës.
 - ii. Institucionet për të cilat Platforma Dyqani.im është i detyruar me legjislacionin në fuqi, kundrejtë një vendimi të plotfuqishëm.

13. Autorizimi për t'ju kontaktuar; regjistrimi i thirrjeve; analizimi i përmbajtjes të mesazheve

- a. Platforma Dyqani.im mund t'ju kontaktojë duke përdorur thirrje ose mesazhe, në çdo numër telefoni që ju keni siguruar, që: **(i)** t'ju njoftojë në lidhje me llogarinë tuaj; **(ii)** të zgjidhë probleme potenciale lidhur me llogarinë tuaj; **(iii)** të zgjidh një mosmarrëveshje; **(iv)** të mbledhë një borxh; **(v)** të kërkojë mendimet tuaja përmes anketave ose pyetësorëve; ose **(vi)** siç është e nevojshme ndryshe për t'i shërbyer llogarisë tuaj ose për të zbatuar këtë marrëveshje, politikat tona, ligjin në fuqi ose çfarëdo marrëveshje tjetër që mund të kemi me ju. Platforma Dyqani.im gjithashtu mund t'ju kontaktojë duke përdorur thirrje ose mesazhe për qëllime të marketingut (p.sh., oferta dhe promovime), nëse pranoni një komunikim të tillë. Mbledhja, përdorimi, përpunimi, zbulimi, ruajtja dhe mbrojtja e informacionit tuaj personal rregullohet nga Ligji NR. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Siç përshkruhet në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe sipas parimit të kufizimit të ruajtjes, të dhënat personale mund të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përmbushjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin përkatës për Arkivat

Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër në fuqi. Platforma Dyqani.im nuk do t'i shesë, shpërndaj ose jep me qira informacionet tuaja personale te palët e treta përveç nëse ka lejen tuaj ose i kërkohet nga ligji për ta bërë këtë.

- b. Platforma Dyqani.im, ka të drejtë që pas dhënies së paralajmërimit, të monitorojë ose regjistrojë biseda telefonike që ju ose kushdo që vepron në emrin tuaj, zhvillon me Platformën Dyqani.im ose nënkontraktorët e Platformës, për kontrollin e cilësisë dhe për qëllim të trajnimit, apo për mbrojtjen e tij.

14. Ndarshmëria dhe nuliteti i dispozitave

- a. Nëse një apo më shumë dispozita të kësaj marrëveshje konsiderohen si nule nga institucioni kompetent, kjo nuk do të ndikojë në validitetin e kontratës si tërësi dhe dispozitat tjera do të mbesin në fuqi.

15. Amendamenti i Marrëveshjes

- a. Në rast të amendamentit të termeve dhe kushteve të kësaj marrëveshje, Platforma Dyqani.im do t'iu njoftoj për propozimet e amendamentit të kësaj marrëveshje një (1) muaj nga data e hyrjes në fuqi.
- b. Ju keni të drejtën e ndërprerjes së kësaj marrëveshje në rast se nuk jeni i kënaqur me amendamentet e bëra, brenda periudhës kohore të paraparë në paragrafin e mësipërm, pa ndonjë gjobë apo kosto shtesë.
- c. Nëse ju nuk e kundërshtoni marrëveshjen e amendamenteve brenda periudhës një (1) mujore, gjegjësisht para hyrjes në fuqi të amendamenteve të kësaj marrëveshje, Platforma Dyqani.im do të konsiderojë se ju jeni pajtuar me kushtet e reja sipas amendamentimit. Dhe, nga momenti i hyrjes në fuqi të amendamenteve, marrëdhënia kontraktuale në mes juve dhe Platforma Dyqani.im do të rregullohet me anë të versionit të amendamentuar të kësaj marrëveshjeje.